



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura V**  
**Sesioni vjeshtor**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike  
Mbledhja nr. 35  
Prishtinë, më 19 tetor 2016, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-II-

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Faton Topalli, Ali Sadriu, Hajdar Beqa, Abdyl Ymeri, Bali Muharremaj, Synavere Rysha dhe Enver Hoti.

**Mungoi:** Naim Fetahu dhe Fikrim Damka.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Antigona Ibraj, koordinatorë e Komisionit; Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi.

**Pjesëmarrësit tjerë në takim:** Kosum Aliu, Enis Spahiu dhe Afrim Shala nga Ministria e Financave, Safet Berisha nga Zyra Kombëtare e Auditimit, dhe Fjolla Uka nga KDI.

**Në këtë mbledhje u propozua ky**

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike
3. Të Ndryshme.

*Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Kryetari, konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

**2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike**

**Kryetari**, theksoi se Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike me datë 07.10.2016, ka pranuar Projektligji për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, nga Qeveria e Republikës së Kosovës përkatësisht Ministria e Financave në cilësi të sponsorizuesit. Në prill të vitit 2015 Qeveria ka miratuar Strategjinë e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike 2015 – 2019. Krijimi i kornizës ligjore adekuate për zhvillim të mëtejshëm të sistemit të KBFP-së, i përbërë nga Menaxhimi Financiar, Kontroll dhe Auditim të Brendshëm është një veprim me prioritet i përcaktuar në Strategjinë e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike 2015 – 2019. Andaj, Projektligji për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike ka për objektiv që të përmirësojë, fuqizojë dhe standardizojë edhe më tutje bazën ligjore dhe organizative, në nivel qendror dhe lokal. Së bashku me projektligjin këtij dokumenti ju janë bashkangjitur edhe, deklarata e përputhshmërinë me Legjislacionin e ACQUIS e BE-së nga Ministria e Integritetit Evropian. Vlerësimin e ndikimit Buxhetor nga Ministria e Financave si dhe Memorandumin Shpjegues. Ashtu siç kërkohet me standarde të përgatitjes së Legjislacionit.

Ky Projektligj ka 36 nene në 6 kapituj, dhe rregullon sistemin e kontrollit të brendshëm të financave publike, që përfshin menaxhimin financiar dhe kontrollin, auditimin e brendshëm, si dhe harmonizimin e tyre, në pajtim me standardet ndërkombëtare për kontrollin e brendshëm dhe auditimin e brendshëm. Në kapitullin e parë të Projektligjit janë rregulluar qëllimi, fushëveprimi dhe përkufizimet e përdorura në Projektligj. Kapitulli i dytë i Projektligjit rregullon menaxhimin financiar dhe kontrollin, ku rregullohet llogaridhënia menaxheriale e udhëheqësit të subjektit të sektorit publik e Zyrtarit Kryesor Administrativ, Zyrtarit Kryesor Financiar, drejtuesve të niveleve vartëse dhe të mbajtësve tjerë të buxhetit të subjekteve të sektorit publik. Po ashtu, ky kapitull rregullon komponentët e menaxhimit financiar dhe të kontrollit dhe raportimin për sistemin e kontrollit të brendshëm. Auditimi i Brendshëm rregullohet në kapitullin e tretë të Projektligjit, ku rregullohet themelimi, funksionimi parimet e auditimit të brendshëm, si dhe Komiteti i Auditimit. Ky kapitull po ashtu rregullon pavarësinë funksionale të njësive të auditimit të brendshëm, përbërjen dhe rekrutimin e stafit, përgjegjësinë e udhëheqësit të subjektit të sektorit publik për këtë njësi si dhe çështjet tjera që ndërlidhen me funksionimin e kësaj njësie. Në kapitullin e katërt trajtohet bashkërendimi dhe harmonizimi i kontrollit të brendshëm të financave publike, ku rregullohen përgjegjësitë e Ministrit të Financave, Këshillit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike dhe të Njesisë Qendrore Harmonizuese për Menaxhimin Financiar, Kontroll dhe Auditim të Brendshëm. Në kapitullin e pestë përcaktohen hapat për raportimin e parregullsive, ndërsa kapitulli i fundit trajton dispozitat përfundimtare dhe kalimtare. Andaj bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit, si dhe në Rregullorën e punës së komisionit kërkohet që në aspektin procedural para se ky projektligj të kalon në lexim të parë në seancë plenare të aprovohen fillimisht në lexim të parë në Komision.

Bazuar në këtë ju rekomandojë që të aprovojme në lexim të parë projektligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike. Me këtë hapi diskutimin.

**Ali Sadriu**, theksoi se ky projektligj do të analizohet në detale pas aprovimit në seancë plenare, megjithatë fokusi ynë do të jetë në krijimin e një bazë të qëndrueshme ligjore për funksionim

efektiv dhe efikas të parasë publike. Ne jemi në pajtim që ky projektligj të përkrahët në parim dhe të shkon për në Seancë Plenare.

**Bali Muharremaj**, pyeti cila është arsyeja që Ministria e Financave ka propozuar Projektligjin për Kontrollin e Brendshëm Financiar, ku dihet se ekziston Ligji për Auditimin e Brendshëm, pra çka ofron me konkretisht ky projektligj? Në opiniononin publik eksiton një skepticizëm se me sistemin e ri të gradimit Auditorët e Brendshëm nuk do ta kenë lartësinë e njëjtë të pagave siç e kanë pasur me herët. Përmes këtij projektligji a do të jenë të kategorizuar njëjtë Auditorët e Brendshëm? Njësia për Menaxhimi Financiar dhe Kontroll që deri vonë ishte në kuadër të Ministrisë së Financave, përkatësisht në kuadër të Departamentit të Thesarit, me ndryshimin plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike është bartur në kuadër të Njesisë Qendrore harmonizuese, a u janë shtuar përgjegjësitë, dhe si ndikon ky projektligj në të drejtat dhe kompetencat që i kanë tek kjo njësi?

**Hajdar Beqa**, theksoi se ky projektligj do të analizohet në detale pas aprovimit në parim. Për atë sa kemi vërejtur tek dispozitat shfuqizuese në nenin 34 paragrafi 1 pika 1.1 ky nen është në kundërshtim me nenin 33 paragrafin 3 të këtij projektligji.

**Synavere Rysha**, theksoi se projektligji për kontrollin e brendshëm financiar është i dizajnuar për të rritë sigurinë më të lartë në kontrollin e shpenzimit e parasë publike. Kontributin tonë në amandamentimin e këtij projektligji do të japim pas aprovimit në parim në Seancë Plenare.

**Kosum Aliu, Drejtor i NJQHAB**, shtoi se Ministria e Financave me rastin e përgatitjes së këtij projektligji ka themeluar një grup punuese duke përfshirë të gjithë akterët e rëndësishëm, me qëllim që ky projektligj të jetë gjithëpërfshirës dhe i zbatueshëm nga të gjithë. Po ashtu paraqiti në pika të shkurta një rekapitullim për të gjithë 6 kapitujt e këtij projektligji, si dhe u përgjigj në pyetjet e deputetëve. Ka dyshime se paga e auditorëve të brendshëm mund të zvogëlohet në bazë të katalogimit të vendeve të punës. Për me konkretisht ekziston incizimi i këtij diskutimi.

**Kryetari**, propozojë se komisioni duhet të vendosë për aprovimin në parim të Projektligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, dhe të caktojë grupin punues për shqyrtim dhe amandamentim të këtij projektligji.

*Përfundim*

*KMFP, vendosi që të aprovohet në parim Projektligji për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, ku anëtarë të grupit punuese të jenë të gjithë deputetët e KMFP-së. Po ashtu në ditët në vijim të organizohet një punëtori dy ditore për të shqyrtuar dhe amandamentuar Projektligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.*

### **3. Të Ndryshme.**

**Kryetari**, kërkoj nga deputetët që plani i punës së komisionit për shqyrtim të raporteve deri në fund të vitit të rishikohet për shkak se me sa po duket nuk po japim rezultate. Mendoje se më mirë është të shikojmë një numër të raporteve të auditimit të PVF-ve dhe të merremi me adresimin e rekomandimeve të dhëna paraprakisht nga komisioni. Me këtë takim përfundojë

Takimi përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

---

Faton Topalli